



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 669/15 Prot.

Tiranë, më 30.12. 2015

V E N D I M
Nr. 142, datë 30.12.2015

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr.669/1 prot, datë 13.10.2015**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Bashkinë Pukë, për rastin e nëpunëses ***** ,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit nr.669/1 prot, të datës 13.10.2015, pasi shqyrtova informacionin e përcjellë nga punonjësja ***** , rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 669 prot, datë 02.10.2015, vendosa nisjen e verifikimit në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak ristrukturimi, të kësaj punonjëse, si "Përgjegjëse e Zyrës së Financës" në Njësinë Administrative Gjegjan, Pukë.

Nga aktet e administruara rezulton se, punonjësja ka filluar punë, në datë 01.10.1992, me akt emërimi, në pozicionin e punës "Kryetare e Degës së Financës" pranë Komunës Gjegjan. Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), e ka gjetur atë në të njëjtin pozicion pune. Me të drejtë njësia përgjegjëse e Komunës Gjegjan , me aktin nr. 1108/4 prot, datë 26.09.2014, e ka konfirmuar statusin e punonjësës, si nëpunëse civile në pozicionin e punës "Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe Ekonomisë", sipas strukturës organizative të miratuar me vendimin nr.2, datë 29.01.2014. Në këtë pozicion ajo është riemëruar edhe me

Vendimin nr. 7, datë, 27.02.2015, të kryetarit të komunës, dalë në zbatim të strukturës së miratuar me Vendimin nr. 3 dhe 4, datë, 29.01.2015 të Këshillit të Komunës Gjegjan *“Për miratimin e strukturës organizative, organikave analitike të administratës dhe të punonjësve e punëtorëve të sektorit të shërbimeve publike”*.

Bazuar në ligjin nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*, dhe ligjin nr. 30/2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, Këshilli Bashkiak Pukë, me Vendimin nr. 7, datë 03.08.2015, ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësive administrative të saj.

Mbi këtë bazë, Kryetari i Bashkisë Pukë, me Urdhrin nr. 59, datë 14.08.2015, ka miratuar strukturën tranzitore të administratës së Bashkisë dhe njësive administrative, pjesë përbërëse të këtij institucioni.

Sipas kësaj strukture, rezulton se Njësia Administrative Gjegjan, ka pësuar shkurtim të numrit të vendeve të punës, nga **31** pozicione që kishte struktura e mëparshme, (prej të cilave **8** pozicione pune pjesë e shërbimit civil), në **23** pozicione në strukturën e re (prej të cilave **4** pozicione pune pjesë e shërbimit civil).

Nisur nga ky fakt, arrij në përfundimin se subjekti është përfshirë në një proces real ristrukturimi, pasi rezulton se ka shkurtim të numrit të pozicioneve të punës dhe riorganizim të tyre. Por, nga ana tjetër, konstatoj se Kryetari i Bashkisë Pukë, edhe pse përmend si bazë ligjore nenin 50, pika 6, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil” (i ndryshuar)*, ka njoftuar punonjësen *****, me shkresën nr.606/1 prot, datë, 08.09.2015 *“Për zbatimin e procedurës për lirin nga shërbimi civil”*, dhe më pas, me shkresën nr.712/4 prot, datë, 18.09.2015, *“Për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, në njësinë administrative Gjegjan për shkak ristrukturimi”*, duke mos respektuar procedurën e parashikuar nga kjo dispozitë, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës të kësaj punonjëseje.

Në rastin konkret, konstatoj se bazuar në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil” (i ndryshuar)*, fillimisht duhej të ishte ngritur Komisioni i Ristrukturimit të Bashkisë Pukë, i cili kishte për detyrë të shqyrtonte mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe më pas të bënte propozimin përkatës për njësinë përgjegjëse (njësinë e burimeve njerëzore) për transferimin e nëpunësit, vendi i punës të të cilit është shkurtuar, në një pozicion tjetër të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike.

Nga shqyrtimi i strukturës së re të institucionit, rezulton se kemi shkurtim të pozicionit të punës *“Përgjegjës i Zyrës së Financës dhe Ekonomisë”*, por ndërkohë në këtë sektor, ekziston pozicioni i punës *“Specialist Finance”*. Detyra e Komisionit të Ristrukturimit në këtë rast, duke u bazuar në rregullin e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ishte të vlerësonte fillimisht, nëse ekzistonte mundësia për sistemimin në këtë pozicion të mbetur, të punonjëses që mbante më parë pozicionin e përgjegjëses së kësaj zyre (dmth, nëpunëses *****), duke evidentuar edhe pëlqimin ose jo të saj me shkrim.

Vetëm nëse kjo nëpunëse, nuk plotësonte kërkesat e veçanta, sipas përshkrimeve të reja të punës, apo në rast të mospranimit të vendit të punës, mund të vijonte procedura e plotësimit të

pozicionit nëpërmjet transferimeve, sipas radhës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 50 të ligjit në fjalë, apo të vendosë ndërrerjen e marrëdhënies së punës.

Nga hetimi administrativ i praktikës dokumentare për mënyrën si është proceduar në rastin konkret, konstatohet se ekziston vetëm akti administrativ për ndërrerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit dhe mungon : *a.* urdhri për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; *b.* dokumentacioni që materializon mënyrën si ka funksionuar ky komision dhe propozimet e tij në lidhje me transferimet, rrimërimet dhe lirimet nga shërbimi civil të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar apo ristrukturuar pozicioni i punës; *c.* Aktet administrative që provojnë marrjen e pëlqimit me shkrim nga nëpunësit të cilët janë të detyruar të transferohen në një pozicion tjetër për shkak të shkurtimit ose ristrukturimit të pozicionit të mëparshëm të punës; *ç.* aktet administrative që evidentojnë vendimmarrjen përfundimtare të njësishë përgjegjëse, për miratimin apo refuzimin e propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit .

Nisur nga sa më sipër, arrij në përfundimin se akti nr. 712/4 prot., dt. 18.09.2015 i Kryetarit të Bashkisë Pukë, për ndërrerjen e marrëdhënies së punës të nëpunëses ***** për shkak të ristrukturimit të institucionit, është nxjerrë duke mos respektuar rregullat dhe procedurën e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; Kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimet nga shërbimi civil”* dhe Udhëzimi nr. 3, datë 14.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*.

Përfundimisht, çmoj se kjo shkelje e rëndë e procedurës, në bazë të neneve 115/a, 116/c dhe 117/1, të ligjit nr. 8485, dt.12.5.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative”*, sjell pavlefshmëri absolute të aktit administrativ nr. 712/4 prot, datë 18.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Pukë *“Për ndërrerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në njësine administrative Gjegjan për shkak ristrukturimi”*. Për këtë arsye, ky akt administrativ duhet të revokohet dhe procesi i ristrukturimit si për rastin e punonjës ***** , ashtu dhe për gjithë rastet e tjera të ngjashme, të kryhet nga fillimi sipas kërkesave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe akteve përkatëse nënligjore.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenet 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative në R.SH”*; nenin 35 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e aktit administrativ nr. 712/4 prot, datë 18.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Pukë *“Për ndërrerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në njësine administrative Gjegjan për shkak ristrukturimi”*, për punonjës ***** .

2. Të kryhet procesi i ristrukturimit të institucionit, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 50, pika 3 e vijues, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke filluar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili duhet të funksionojë dhe veprojë sipas përcaktimeve dhe afateve ligjore, të vendosura në Kreun II dhe III, të Vendimit nr. 171, dt.26.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*.
3. Në rastin e pamundësisë së sistemimit të punonjësve që u është shkurtuar ose ristrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke u njohur atyre, përfitimet prej pikave 7 dhe 8 të nenit të mësipërm, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.
4. Bashkia Pukë, të zbatojë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni, dhe pas këtij afati të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për zbatimin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Pukë dhe kërkesja ***** .
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA